

## KONTRATË DHURIMI (Kuotash të Shoqërisë)

Në Tiranë, sot më datë 15.09. 2023, duke u bazuar në legjislacionin shqiptar, në veçanti në Kodin Civil të Republikës së Shqipëriaë, neni 659 e vijues; në ligjin Nr. 9901, date 14.04.2008, "Për Tregtarët dhe shoqëritë Tregtare", i ndryshuar, nenet 72-75 të tij dhe në ligjin Nr.9723 date 03.05.2007 "Për regjistrimin e biznesit" i ndryshuar, lidhet kjo Kontratë Dhurimi, midis palëve të mëposhtme:

### PALA E PARË:

**Znj. Diana Zebi**, e bija e Faizit dhe e Hatixhes, e datëlindjes 24.01.1963, lindur dhe banuese në Tiranë, ne adresen sheshi Jozef San Martin, P.3, Ap.9 Njesia Bashkiake nr.5, K. 1019, Tiranë, me kombësi dhe shtetësi shqiptare, e martuar me Z.Nerulla Zebi, madhore dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, me nr. karte ID nr personal G35124030C, që këtu e në vijim "**Dhuruesi**"

**Jep pëlqimin, Z. Nerulla Zebi**, i biri i Mexhitit dhe i Danes, lindur më 20.06.1956 në Dohoshisht, Peshkopi, banues në Tiranë, ne adresen sheshi Jozef San Martin, P.3, Ap.9 Njesia Bashkiake nr.5, K. 1019, Tiranë, me kombësi dhe shtetësi shqiptare, i martuar me znj Diana Zebi, madhore dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, me nr. karte ID nr personal F60620056F;

dhe

### PALA E DYTË:

**Z. Ylli Zebi**, i biri i Qazimit dhe i Dallëndyshes. i datëlindjes 09.08.1974, lindur në Dohoshisht, Peshkopi, Dibër dhe me banim në Dohoshisht, me kombësi dhe shtetësi shqiptare, i martuar, madhore dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, me nr. karte ID nr personal H40809130P, që këtu e në vijim. "**Përfituesi**".

### HYRJE

A. Shoqërisa "BIG Peshkopia" shpk, është person juridik i regjistruar në regjistrin tregtar pranë QKB më datë 26.02.2019, pajisur me nipt L96426701R, me seli në adresën Dibër, Peshkopi, lagjia Aksioni, kati përdhe i godinës së shoqërisë Albadi shpk (Xhelil Mazari) nr.pasurisë 14/315-N, (Supermarketi) me ortakë:

- Znj. **Diana Zebi**, Vlera e Kapitalit 2.400.000,00; Numri i Pjesëve 1 (një); Pjesëmarrja në përqindje 24%;
- Z. Musa Ricku, Vlera e Kapitalit 2.500.000,00; Numri i Pjesëve 1 (një); Pjesëmarrja në përqindje 25%;
- Shoqëria BIGALB GROUP Vlera e Kapitalit 5.100.000.00; Numri i Pjesëve 1 (një); Pjesëmarrja në përqindje 51%;

- B. Kapitali i Shoqerisë është shlyer rregullisht nga ortakët, të cilët nuk kanë asnjë detyrim të papërbushur dhe/ose të shkelur në lidhje me shlyerjen e kapitalit të Shoqerisë;
- C. Dhuruesja, Zonja Diana Zebi, dëshiron t'i dhurojë, pa kundërshpërblim, Përfituesit Z. Ylli Zebi 8% të kapitalit, nga pjesa prej 24% , të zotëruar prej prej saj. Dhuruesja deklaroi se është pronare e ligjshme e Kuotave, ka titull të plotë pronësie mbi ta dhe zoteron të gjithë interesin e përfitimit kundrejt këtyre Kuotave.
- D. Ortakët, e tjerë, "Bigalb Group" Sh.p.k, përfaqësuar nga Znj. Elona Koshi, me cilësinë e "Personit të Besuar" Z. Vullnet Sinaj, dhe Zoti Musa Riçku, me vendimin Nr. 04 të datës 15.09.2023, në mënyrë të shprehur kanë dhënë miratimin e tyre për këtë dhurim.
- E. Përfituesi, Z. Ylli Zebi, shtetas shqiptar, me banim Dohoshisht Peshkopi, bën pjesë në rrethin familjar të Dhuruesve.

Palët, në mirëkuptim të plotë, bien dakort për redaktimin dhe nënshkrimin e kësaj Kontrate Dhurimi me termat në vijim:

### Neni 1. Objekti

- 1.1 Sipas kushteve dhe parashikimeve të kësaj Kontrate, Dhuruesja Znj. Diana Zebi transferon nëpërmjet dhurimit, duke kaluar në emër të Përfituesit Z. Ylli Zebi, respektivisht 8 % (tete) përqind të kapitalit, (kuotave) nga pjesa prej 24% , të zotëruara prej sajë.
- 1.2 Palët bien dakord që pas nënshkrimit të kësaj Kontrate, Përfituesi do të ushtrojë të gjitha të drejtat që lidhen dhe rrjedhin nga pronësia mbi pjesën e kapitalit të dhuruar nga Dhuruesi
- 1.3 Pas realizimit të dhurimit të kuotave, numri i përgjithshëm i kuotave, në shoqërinë "Big Peshkopia" shpk, bëhet 4 (katër), që do të zotërohen nga :
- Ortaku: **Shoqëria BIGALB GROUP:** Vlera e kapitali 5 100 000,00; Numri i Pjesëve 1 (një); Pjesëmarrja në përqindje 51%;
- Ortaku: **Z. Musa Riçku:** Vlera e kapitalit 2 500 000,00; Numri i Pjesëve 1 (një); Pjesëmarrja në përqindje 25%;
- Ortaku: **Znj. Diana Zebi:** Vlera e Kapitalit 1.600 000, 00; Numri i Pjesëve 1 (një); Pjesëmarrja në përqindje 16%;
- Ortaku: **Ylli Zebi:** Vlera e Kapitalit 800 000, 00; Numri i Pjesëve 1 (një); Pjesëmarrja në përqindje 8%;

### Neni 2. Afati

- 2.1 Momenti i kalimit të kotave do të jetë data e nënshkrimit të kontratës nga palët.

### Neni 3. Vlera e dhurimit. Tatimet. Shpenzimet.

- 3.1 Kuota me pjesëmarrjen në përqindje 8% ( tetë për qind), që do të dhurohet, ka vlerën 800 000,00 Lekë.

- 3.2 Palët do të perballojnë kostot dhe shpenzimet e tyre përkatëse që kanë kryer në lidhje me negocimin dhe nënshkrimin e kësaj Kontrate.
- 3.3 Përfituesi do të jetë përgjegjës për pagesën e çdo tatimi të aplikueshem në lidhje me pjesën e kapitalit të dhuruar, pas nënshkrimit të kësaj kontrate.

#### Neni 4 Pranimi

- 4.1 Për të shmangur çdo paqartësi dhe/ose dyshim, Përfituesi pranon pjesët e kapitalit të dhuruar, si më sipër, në përputhje me kushtet dhe kufizimet e parashikuara në këtë Kontratë dhe në Statutin e Shoqërisë.
- 4.2 Përfituesi me ane të kësaj Kontrate deklaron dhe garanton Dhuruesin se:
- a) Ka të gjithë aftësitë juridike për të nënshkruar këtë Kontratë dhe se nuk ka asnjë pengesë ligjore që do të cënonte aftësinë e tij për të nënshkruar, apo përmbushur detyrimet që rrjedhin nga kjo Kontrate dhe kjo Kontratë përbën një detyrim të vlefshëm të Përfituesit të zbatueshëm në përputhje me dispozitat e kësaj Kontrate;
  - b) Përmbush të gjitha kriteret për të ushtruar veprimtarinë e parashikuar në statutin e Shoqërisë;
  - c) Nuk ka asnjë fakt, rrethane apo informacion i cili mund të cënojë në çfarëdo mënyre aftësinë e tij për të ushtruar të drejtat dhe zbatuar detyrimet që rrjedhin nga zoterimi i pjesës së kapitalit të dhuruar.

#### Neni 5 Te ndryshme

- 5.1 **Garanci te tjera.** Palët bien dakord që të ndermarrin ato veprime të tjera të cilat nuk parashikohen shprehimisht në këtë Kontratë, siç mund të jetë e nevojshme apo dëshirueshme për realizimin e dhurimit të pjesëve të kapitalit të dhuruar sipas afateve dhe kushteve të përcaktuara në këtë Kontratë. Me ndryshimin apo hyrjen në fuqi të ndonjë ligji, rregulli apo rregulloreje që do të ndikojë aftësinë e Dhuruesit për të dhuruar pjesën e kapitalit që zotëron apo të Përfituesit për të pranuar pjesën e kapitalit të dhuruar sipas kushteve të kësaj Kontrate, Palët bien dakord që të ndermarrin veprime të tjera siç mund të jetë e nevojshme apo e dëshirueshme dhe pranojnë në mirëbesim të kryejnë këto procedura siç mund të jetë e nevojshme apo e dëshirueshme për realizimin e dhurimit të pjesëve të kapitalit, në përputhje me të gjitha ligjet, rregullat ose rregulloret që bëhen të zbatueshme; me kusht, gjithsesi, që asnjërës Palë të mos i kërkohet që të ndermarrë ndonjë prej këtyre veprimeve apo të respektojë ato procedura që do t'i shkaktonin një barrë të rëndë apo kosto dhe shpenzime shtesë.
- 5.2 **Marreveshja.** Kjo Kontratë përbën të gjithë Marrëveshjen dhe zëvendëson të gjitha marrëveshjet dhe rregullimet e mëparshme, verbale dhe të shkruara, ndërmjet Palëve në lidhje me objektin e kësaj Kontrate.
- 5.3 **Transferimi.** Asnjëra palë nuk do të ketë të drejtë të jape apo transferojë të gjitha apo cilëndo prej të drejtave të saj, përfitimeve apo detyrimeve sipas kësaj Kontrate, pa miratimin paraprak me shkrim të palës tjetër dhe të ortakëve të tjerë.



- 5.4 **Efektet detyruese.** Kjo Kontrate do të ketë fuqi detyruese për Palët, nga momenti i nënshkrimit të saj.
- 5.5 **Vegueshmeria.** Nëse ndonjë prej dispozitave të kësaj Kontrate konsiderohet e pavlefshme, e paligjshme apo e pazbatueshme, ajo do të modifikohet në minimumin e nevojshem për ta kthyer të vlefshme, të ligjshme dhe të zbatueshme, ose, nëse një modifikim i tillë nuk është i mundur, kjo dispozitë do të menjahet nga kjo Kontratë dhe dispozitat e tjera të kësaj Kontrate do të vazhdojnë të jenë plotësisht në fuqi dhe të vlefshme.
- 5.6 **Ligji i zbatueshëm.** Kjo Kontratë dhe të gjitha transaksionet e parashikuara në të do të rregullohen, interpretohen dhe do të jenë të zbatueshme në përputhje me legjislacionin shqiptar.
- 5.7 **Zgjidhja e mosmarrëveshjeve.** Çdo konflikt, ndryshim, mosmarrëveshje apo pretendim i çfarëdo loji, sido që të ketë lindur, nga apo në lidhje me këtë Kontrate, përfshirë çdo pyetje që i përket mospërbashkimit, ekzistencës, vlefshmerisë apo zgjidhjes së kësaj Kontrate, të cilat nuk zgjidhen në mënyrë miqësore mes Palëve, do t'i drejtohet dhe zgjidhet përfundimisht nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor, Tiranë.
- 5.8 **Gjuha dhe kopjet.** Kjo Kontratë nënshkruhet në 4 (katër) kopje origjinale në gjuhën shqipe.
- 5.9 **Hyrja në fuqi** Kjo kontratë hyn në fuqi me nënshkrimin e saj nga Palët.
- 5.10 **Bashkangjitur dokumentat:** Ekstrakt i Regjistrimit Tregtar të Shoqërisë "BIG Peshkopia" shpk; Vendim Nr. 04, datë 15.09.2023 i Shoqërisë "Big Peshkopia" shpk; Dokumentat ID të palëve

Kontrata lexohet nga ne palët dhe pasi gjendet konform ligjit dhe vullnetit tonë të lirë, e nënshkruajmë atë rregullisht.

**PALËT:**

**DHURUESI**

Znj Diana Zebi

*DIANA ZEBI*

*[Signature]*

JEP PËLQIMIN

NERULLA ZEBI

*Nerulla Zebi*  
*[Signature]*

**PËRFITUESI**

Z. Ylli Zebi

*Ylli Zebi*

*[Signature]*